

URDHËR
Nr. 479, datë 24.10.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 249, DATË 11.6.2021, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË, SLOVAKISË, HUNGARISË, GJERMANISË, UKRAINËS, ÇEKISË, RUMANISË, BULLGARISË, BELGJIKËS, KROACISË, DANIMARKËS, FRANCËS, HOLANDËS DHE ITALISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 249, datë 11.6.2021, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës dhe Italisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca